



NDIKIMIT I PANDEMISË COVID 19 TEK KOMUNITETI ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

Analizë në Komunën e Prizrenit



PRISHTINË,
SHTATOR 2022



Përbajtja

Autor: Qëndrim Arifi

Magjistër i shkencave juridike-civile

*Ky publikim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, përmes nismës së Rrjetit tw Grave tw Kosovws.
“Ngritja e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së OShC-ve: Avancimi i barazisë gjinore në mes të pandemisë COVID-19”.*

Përbajtja e tij është përgjegjësi e OJQ-së Foleja dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përbajtja

1.	Hyrja.....	4
2.	Metodologja	5
3.	Pandemia Covid 19 dhe komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.....	6
4.	Pandemia Covid 19 dhe vështirësitet ekomomike të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian	6
5.	Pandemia Covid 19 dhe dhuna në familje tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian	13
6.	Pakos e Ringjalljes Ekonomike dhe ndikimi i saj tek komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian	19
7.	Ndikimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian	20
7.1.	Masa 1 - Mbështetja e Punësimit - 50 milionë Euro	21
7.2.	Masa 2 - Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit – 108 milionë Euro	24
7.3.	Masa 3 - Mbështetja për familjen – 50 milionë Euro	25
7.4.	Masa 4 – Mbështetja për publikën – 112 milionë Euro	27
7.5.	Masa 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient – 100 milionë Euro	28
8.	Gjetjet kryesore.....	30
9.	Rekomandime	32

I. Hyrja

Pandemia Covid 19 përveç pasojave të shumta të cilat janë karakterizuar me vdekje të qytetarëve si dhe me dëmtime të shumta në shëndetin e atyre që kanë arritur të mbijetojnë virusin, në të njëjtën kohë pas vete ka lënë dhe vazhdon të lë edhe shumë pasoja tjera, tejkalimi i të cilave kërkon ndërhyrje dhe strategji shtetërore dhe padyshim kjo do të marrë kohë.

Përveç pasojave direkte në shëndetin e qytetarëve, pandemia Covid 19 është karakterizuar edhe me pasoja të shumta të cilat posaçërisht kanë të bëjnë me pozitën sociale, e ekonomike të qytetarëve dhe jo vetëm. E gjithë kjo për shkak të shumë masave imponuese që ka sjellë me vete kjo pandemi, duke filluar nga mbyllja e qytetarëve, përkatesisht largimi nga vendet e tyre të punës, aktiviteti i ulët ekonomik, ngritja e çmimeve të produkteve bazë e kështu me radhë. Këto efekte të pandemisë kanë dëmtuar të gjithë qytetarët pa dallim, mirëpo më të dëmtuarit padyshim se janë qytetarët me të ardhura të ulëta dhe që jetojnë në kushte të vështira ekonomike.

Qëllimi i analizës është të pasqyroj ndikimin e pandemisë Covid 19 tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit, përkatesisht nëpërmjet kësaj analizë do të pasqyrohen pasojat kryesore të pandemisë Covid 19 tek pjesëtarët e këtyre komuniteteve që jetojnë në Komunën e Prizrenit.

Analiza është e ndarë në tri pjesë kryesore: vështirësitet ekonomike të komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian si pasojë e pandemisë Covid 19, dhuna në familje dhe Covid 19, si dhe ndikimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike të Qeverisë tek pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Pjesa e parë shpjegon se si me paraqitjen e pandemisë Covid 19, pjesëtarët e komunitetit, rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë në kushte më të vështira ekonomike, se një pjesë e madhe e tyre janë nën asistencë sociale, se si është rritur kërkesa për një vend punë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës e kështu me radhë. Në pjesën e dytë trajtohet fenomeni shumë shqetësues i dhunës në familje, duke prezantuar të dhëna nga institucionet si: prokuroria, gjykatat, policia, qendrat për strehimin e viktimate etj, të cilat dëshmojnë se me paraqitjen e pandemisë Covid 19 në të njëjtën kohë kemi pasur edhe një rritje shumë shqetësuese të rasteve të dhunës në familje tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Pjesa e fundit e analizës shpjegon ndikimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, ku përfundohet se vetëm një pjesë e vogël e masave ndikojnë direkt tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Analiza përfundon me pasqyrimin e asaj se si Qeveria për Pakon e Ringjalljes Ekonomike nuk ka aplikuar fare konsultime publike si dhe ajo se lidhur me këtë paku nuk ka aplikuar mënyra dhe forma adekuate të informimit të qytetarëve lidhur me pakon, masat dhe format e aplikimit.

2. Metodologjia

Me qëllim të punimit të një analize cilësore e cila do të jep pasqyrë të saktë mbi ndikimin e pandemisë Covid 19 tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian që jeton në Komunën e Prizrenit, janë aplikuar metoda dhe qasje të kombinuara. Fillimi si qasshme nga institucionet relevante lidhur me statistikat ku përfshihen edhe komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian si dhe të dhëna lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike.

Pas kësaj, të dhënat të cilat nuk kanë qenë të qasshme janë kërkuar nëpërmjet kërkesës për qasje në dokumente publike, duke filluar nga Qeveria e Kosovës, Policia, Prokuroria Themelore e Prizrenit, Gjykata Themelore e Prizrenit, Qendra për Punë Sociale në Komunën e Prizrenit, Zyra Regionale për Mbrojtjen e Viktimate të Dhunës në Familje dhe Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Komunën e Prizrenit, e kështu me radhë.

Me qëllim të kuptimit nga afër të pasojave të pandemisë Covid 19 tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, janë aplikuar edhe anketa me qytetarë (gra dhe burra) të moshës madhore (mbi 18 vite) nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të cilët jetojnë në Komunën e Prizrenit. Në këtë drejtim, anë zhvilluar gjithsej 71 anketa, ku 33 e të anketuarve, apo 46.47% kanë qenë gra, ndërsa 38, apo 53.53% kanë qenë burra. Sa i perkat vendbanimit, 81.7% e tyre jetojnë në zonën urbane të Prizrenit, ndërsa 18.3 në zonën rurale.

Me grumbullimin e të dhënavëve nga terreni, dokumentet publike dhe nga dokumentet dhe informatat e siguruara nëpërmjet kërkesave për qasje në dokumente publike është hartuar pastaj edhe analiza. Sa i përket ndikimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian pas vlerësimit të secilës masë janë aplikuar katër kritere apo kategori të ndikimit: ndikim i plotë, i pjesshëm, ndikim i pakët dhe nuk ka ndikim. Ndikim i plotë do të thotë që masa e caktuar ndikon direkt dhe plotësisht edhe tek pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, ndikim i pjesshëm do të thotë se masa ndikon pjesërisht, ndikim i pakët do të thotë që ndikimi i masës është shumë i pakët tek pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, por se nuk mund të thuhet se nuk ka fare ndikim, ndërsa nuk ka ndikim do të thotë që masa e caktuar nuk prekë fare pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Analiza ka filluar më 27.07.2022 dhe ka përfunduar më 15.09.2022.

3. Pandemia Covid 19 dhe komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian

Në Komunën e Prizrenit jetojnë një pjesë e konsiderueshme e popullsisë e cila i përket komunitetit rom, ashkali dh egjiptian, madje në bazë të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, rezulton që Komuna e Prizrenit ka popullsinë më të madhe rome në Kosovë. Në bazë të këtij regjistrimi, rezulton se në këtë komunë jetojnë 2,899 qytetarë nga komuniteti rom, 1,350 ashkali dhe 168 egjiptian.¹

Pandemia Covid 19, përveç efekteve shëndetësore, përkatësisht humbjen e shumë jetëve të njerëzve, në të njëjtën kohë pas vetes ka lënë, e vazhdon të lë pasoja të shumta dhe afatgjata në shumë sfera jetësore, mirëpo me një theks të veçantë në sferën ekonomike dhe sociale. Republika e Kosovës karakterizohet me një zhvillim të ngadalë ekonomik dhe një pjesë e konsiderueshme e buxhetit shkon për skema të ndryshme sociale. Nga afërsisht 1.7 milion banorë, mbi 100,000 prej tyre, apo mbi 25,000 familjen janë nën asistencë sociale për shkak të kushteve të rënda ekonomike². Pa u llogaritur këtu skemat tjera sociale siç janë: pensionet e moshës, pensionet e veteranëve etj.

Pandemia Covid 19 ka prekur të gjitha shtresat e shoqërisë, mirëpo më të prekurit janë padyshim ata qytetarë të cilat kanë të ardhura të ulëta ekonomike, e në këtë drejtim pjesëtaret nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, janë ndër më të prekurit, kjo për shkak të shkallës së lartë të papunësisë dhe kushteve të vështira socio-ekonomike.

4. Pandemia Covid 19 dhe vështirësitetë ekonomike të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian

Ndër efektet negative të pandemisë Covid 19, pas asaj të humbjes së jetëve të njerëzve, pa dyshim që renditen efektet ekonomike. Kjo përfaktin se si pasojë e pandemisë Covid 19, përkatësisht si pasojë e masave shtetërore në kuadër të parandalimit të përhapjes së pandemisë, ekonomia botërore, por edhe ekonomia e Republika e Kosovës është karakterizuar me ulje të theksuar të aktivitetit ekonomik. Në këtë drejtim, shumë biznese janë mbyllur, përkohësisht kanë shkurtuar vendet e punës, e disa të tjera nuk kanë mundur të rikthehen asnjëherë në treg. Në të njëjtën

¹ Për më shumë, shih, Agjencia e Statistikave të Kosovës, e qasshme në: https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Census%20population_Census%202011_3%20By%20Municipalities/tab%205%204.px/table/tableViewLayout1/.

² Shih, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Mirëqenies Sociale, qershor, 2022 i qasshëm në: <https://ask.rks-gov.net/media/6928/statistikat-e-mir%C3%ABrqenies-sociale-qershor-2022.pdf>.

kohë ka pasur rritje të vazhdueshme të çmimeve të produkteve bazë, kështu duke u vështirësuar në dy drejtime ekzistencia dhe qëndrueshmëri ekonomike e qytetarëve.³ Në njëren anë për shkak të mungesës së vendeve të punës, e në anën tjetër për shkak të rritjes së çmimeve të produkteve bazë.

Efektet ekonomike të pandemisë më së shumti i kanë goditur shtresat e varfëra të popullsisë, respektivisht qytetarët të cilët kanë të ardhura të ulëta. Qytetarët të cilët i përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, padyshim që kanë qenë dhe janë ndër kategoritë e qytetarëve më të goditura nga pasojat ekonomike të pandemisë Covid 19. Kjo bazohet në atë se pjesëtarët e këtyre komuniteteve karakterizohen me papunësi ekstreme në nivel të Republikës së Kosovës. Në bazë të vlerësimeve të Zyrës për Çështje të Komuniteteve, vlerësohet se shkalla e papunësisë tek qytetarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në nivel të Republikës së Kosovës është në mes të 90% deri 100%.⁴

Nga 177,781 banorë, sa ka Komuna e Prizrenit, 4,417 banorë, apo 2.48% përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Në këtë drejtim, në Komunën e Prizrenit aktualisht janë nën asistencë sociale gjithsej 758 familje, ndërsa prej tyre 124 familje, apo 16.35% të të gjithë rasteve sociale në këtë komunë i përkasin komunitetit rom ashkali dhe egjiptian.⁵ Sipas statistikave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nga 758 familjet përfituese të skemës sociale, kanë përfituar gjithsej 2,796 anëtarë të familjes, apo mesatarisht 3.68 qytetarë për çdo familje.⁶ Në këtë drejtim, nga totali prej 4,417 qytetarë që i përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit, nga skema sociale përfitojnë më shumë se 456 qytetarë, shto këtu faktin që familjet nga këto komunitete karakterizohen me numër shumë më të madh të anëtarëve të familjes.

Për qëllime të analizë, nga Qendra për Punë Sociale në Komunën e Prizrenit janë kërkuar statistika për vitet 2019, 2020 dhe 2021, për kërkeshat për ndihmë sociale nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian dhe aprovimin ose refuzimin e tyre. Të dhënrat i gjeni në tabelën më poshtë.

Numri i familjeve nën asistencë sociale nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit, gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 ⁷								
2019			2020			2022		
Kërkesa	Aprovim	Refuzim	Kërkesa	Aprovim	Refuzim	Kërkesa	Aprovim	Refuzim
123	123	0	121	121	0	124	124	0

Tabela I: Numri i familjeve nën asistencë sociale nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit, gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021.

Nga të dhënrat në tabelë vërehet se numri i kërkeshave për skemë sociale është konstant në tri vitet e fundit, pavarësisht pandemisë Covid 19, nuk vërehet ndonjë rritje e madhe e kërkeshave.

³ Për më shumë shih artikullin me titull “Ngritja e çmimeve në Kosovë ka arritur në nivel kaosi, problemi pa zgjidhje”, i qasshëm në: <https://kontabiliteti-ks.com/ngritja-e-cmimeve-ne-kosove-ka-arritur-ne-nivel-kaosi-he-per-he-problemi-pa-zgidhje/>.

⁴ Për më shumë shih vlerësimet e Zyrës për Çështje të Komuniteteve, e qasshme në: <https://zck-ks.net/?page=1.45..>


⁵ Shih Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Mirëqenies Sociale, qershor, 2022 i qasshëm në: <https://ask.rks-gov.net/media/6928/statistikat-e-mir%C3%ABrqenies-sociale-qershor-2022.pdf>.

⁶ Po aty.

⁷ **Burimi:** Përgjigja ndaj kërkësës për qase në dokumente publike nga Qendra për Punë Sociale e Komunës së Prizrenit, datë 05.08.2022.

Ky është tregues i qartë i asaj që u tha më lartë se pjesëtaret nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në një masë të madhe janë nën skema sociale, andaj nuk vërehet shumë lëvizje si pasojë e pandemisë Covid 19. Mirëpo edhe mbetja në atë nivel do të thotë shumë për gjendjen e pandryshueshme ekonomike të këtyre familjeve.

Në anketat e zhvilluara me pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian del që përkundër kushteve të vështira ekonomike, shteti gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka qëndruar aq sa duhet pranë tyre. Në pyetjen se a jeni përfitues i ndonjë skeme sociale dhe se gjatë periudhës 2020 deri 2022 a keni qenë përfitues i ndonjë ndihme nga niveli lokal apo qendror, përgjigjet i gjeni në grafikonin më poshtë.⁸




Grafikoni I: Ndihma sociale për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Të dhënët në grafikon dëshmojnë se vetëm 4.2% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se ata janë përfitues të ndonjë skeme sociale, ndërsa lidhur me pyetjen se a keni përfituar ndonjë ndihmë direkte nga niveli lokal, përkatesisht komunal, apo nga Qeveria, pozitivisht janë përgjigjur vetëm 12.7% e qytetarëve të anketuar. Në këtë drejtim, këto të dhëna argumentojë se dora e shtetit gjatë këtyre viteve të pandemisë ka qëndruar larg pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Duke u nisua nga ajo që anketat janë zhvilluar me gratë dhe burrat nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, është e rëndësishme të paraqitet edhe dallimi mes tyre sa i përket përgjigjeve të dhëna në anketë. Në vazhdim janë paraqitur përgjigjet e grave dhe burave nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, lidhur me skemat sociale dhe ndihmat shtetërore lidhur me pandeminë Covid 19.

⁸ **Burimi:** Anketat me qytetarët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Dallimet mes grave dhe burrave në kuadër të ndihmave sociale për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian




Grafikoni 2: Dallimet mes grave dhe burrave në kuadër të ndihmave sociale për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Nga të dhënrat në grafikonin më lartë, përfundohet se gratë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me këto pyetje janë deklaruar pozitivisht njëfish më shumë se burrat. Konkrektisht përderisa vetëm 2.60% e burrave kanë deklaruar se janë përfitues të skemave sociale, kjo përqindje tek gratë dyfishohet, ku 6.10% e tyre deklarohen se janë përfituese. Gjithashtu, edhe tek pyetja se a keni qenë përfitues i ndonjë ndihme nga niveli lokal apo qendror, përderisa vetëm 7.90% e burrave deklarojnë se po, kjo përqindje dyfishohet tek gratë, duk arritur në 18.20%.

Asht siç është theksuar më lartë, pandemia Covid 19 ka ndikuar në mënyrë direkte edhe në shkurtimin e vendeve të punës, ku shumë persona kanë mbetur të pa punë, dhe rrjedhimisht në një gjendje të renduar ekonomike. Në këtë drejtim, gjatë zhvillimit të anketave qytetarët nga komuniteti rom, ashkal dhe egjiptian të cilët jetojnë në Komunën e Prizrenit janë pyetur se a kanë humbur vendin e tyre të punës personalisht, apo ndonjë anëtarë tjetër i familjes si pasojë e pandemisë Covid 19, ndërsa përgjigjet i gjeni në grafikonin më poshtë.


Pandemia Covid 19 dhe humbja e vendeve të punës tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian



Grafikoni 3: Pandemia Covid 19 dhe humbja e vendeve të punës tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Të dhënat në grafikonin numër 3 dëshmojnë se vetëm 7% e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian kanë kanë humbur vendin e tyre të punës, ndërsa lidhur me atë se a ka humbur vendin e punës ndonjë familjar i të anketuarve, pozitivisht janë përgjigjur 19.7% të qytetarëve të anketuar. Gjithashtu, duhet theksuar faktin se pjesëmarrja në tregun e punës e qytetarëve të këtyre komuniteteve është mjaftë e ulët, andaj si rrjedhojë edhe humbja e vendeve të punës nuk është shumë e shprehur.

Për qëllime të analizës përgjigjet lidhur me këto pyetje janë krahasuar edhe në aspekt gjinor, përkatësisht është analizuar ajo se si janë përgjigjur gratë dhe burrat lidhur me këto pyetje. Të njëjtitat i gjeni në grafikonin më poshtë.




Grafikoni 4: Humbja e vendeve të punës si pasojë e pandemisë covid 19 tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian-dallimet mes grave dhe burrave.

Në bazë të përgjigjeve në anketë dëshmohet se 9.10% e grave kanë humbur vendin e tyre të punës si pasojë e pandemisë Covid 19, përderisa tek burrat kjo përqindje është më e ulët, përkatësisht 5.30%. Gjithashtu, sa i përket pyetjes se a e ka humbur vendin e punës ndonjë anëtar i familjes si pasojë e pandemisë Covid 19, 21.20% e grave kanë deklaruar se po, përderisa edhe 18.40% e burrave të anketuar e kanë pohuar një gjë të tillë. Në këtë drejtim, konstatohet se dukuria e humbjes së vendeve të punës si pasojë e pandemisë Covid 19 ka goditur më shumë gratë sesa burrat tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Humbja e vendeve të punës, natyrshëm rritë edhe nevojën dhe kërkesën e qytetarëve për punë. Andaj, për qëllime të analizës, përkatësisht për të vërtetuar se si ka ndikuar pandemia në rritjen e kërkesave për punë, nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës është kerkuar numri i qytetarëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian nga Komuna e Prizrenit, të cilët janë drejtuar në këtë Agjenci për të kerkuar një vend pune. Të dhënat janë kerkuar për vitin 2019, përkatësisht viti kur ende nuk ishte shfaqur pandemia në Kosovë, dhe për vitet 2020 dhe 2021, si vite të pandemisë. Të dhënat i gjeni në grafikonin më poshtë.

Numri i punëkërkuesve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Agjencinë e Punësimit gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, Komuna e Prizrenit



Gafikoni 5: Numri i punëkërkuesve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Agjencinë e Punësimit gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, Komuna e Prizrenit.⁹

Nga të dhënrat në grafikonin 5, përfundohet se nëse krahasohet viti 2019 si vit para shfaqjes së pandemisë Covid 19, me një vit pas shfaqjes së saj, kërkesat për punë nga pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, gati janë katërfishuar, përkatësisht nga 8 kërkesa sa ishin në vitin 2019, gjatë vitit 2020 janë rritur në 37 kërkesa. Gjithashtu, edhe në vitin 2021 kanë qenë 22 kërkesa për punë. Ky është fakt i qartë se pandemia Covid 19 ka ndikuar në mënyrë direkte edhe në humbjen e vendit të punës dhe ka shtuar nevojën për punë tek pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, rrjedhimisht edhe në rritjen e kërkesave për punësim në institucionet përkatëse.

Gjatë zhvillimit të anketave, qytetarët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të cilët janë deklaruar si të papunë, janë pyetur se a janë drejtuar në Agjencinë e Punësimit për të kërkuar punë, lidhur me këtë pyetje 93% e të anketuarve janë deklaruar se nuk janë paraqitur në këtë Agjenci, ndërsa vetëm 7% e tyre janë deklaruar që janë paraqitur si punëkërkues. Qytetarët që janë deklaruar që janë paraqitur si punëkërkues në Agjencinë e Punësimit, gjithashtu janë pyetur se kjo Agjenci a u ka siguruar një vend të punës, ndërsa 100% e tyre kanë deklaruar se jo. Shqetësuese mbetet se shumica e qytetarëve të anketuar, përkatësisht 93 % e tyre, as që janë paraqitur në këtë Agjenci. Gjatë zhvillimit të anketave qytetarët janë pyetur se cilat janë arsyet që ata nuk janë paraqitur si punëkërkues në Agjencinë e Punësimit, ndërsa përgjigjet i gjeni në grafikonin më poshtë.

⁹ **Burimi:** Përgjigja nëpërmjet e-mail nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, datë 01.08.2022.

Arsyeja e mos paraqitjes si punëkërkues në agjencinë e punësimit




Grafikoni 6: Arsyja e mos paraqitjes si punëkërkues në Agjencinë e Punësimit.

Nga të dhënrat në grafikon, vërtetohet se shumica e të anketuarve nuk e dinë se ekziston Agjencia e Punësimit, përkatësisht kështu janë përgjigji 58.10% e grave dhe 64.70% e burrave të anketuar. Gjithashtu, si arsyja e mos paraqitjes si punëkërkues në këtë Agjenci, 23.50% e burrave dhe 16.10% e grave e kanë potencuar edhe atë se nuk besojnë se kjo Agjenci mund t'i punësoj, ndërsa pjesa tjeter me 25.80% të grave dhe 11.80% e burrave janë përgjigjur se nuk e shohin të nevojshme që të paraqiten si punëkërkues tek Agjencia e Punësimit.

Të anketuarit gjithashtu janë pyetur se si është gjendja e tyre ekonomike krahasuar me periudhën para pandemisë Covid 19 dhe sot, ndërsa përgjigjet i gjeni në grafikonin më poshtë.

Si është sot situata juaj ekonomike krahasuar me atë para vitit 2020, përkatësisht para shfaqjes së pandemisë Covid 19



Grafikoni 7: Si është sot situata juaj ekonomike krahasuar me atë para vitit 2020, përkatësisht para shfaqjes së pandemisë Covid 19.

Punësimi dhe gjendja ekonomike e njerezve është e lidhur ngushtë me njëra tjetrën. Në këtë drejtim, në pyetjen e parashtruar të anketuarve se si është gjendja e juaj ekonomike krahasuar me atë para shfaqjes së pandemisë Covid 19, pothuajse gjysma e të anketuarve janë përgjigjur se sot gjendja e tyre ekonomike është më e vështirë. Ashtu siç u theksua më lartë, në grafikonin numër 4, gratë janë prekur më së shumti në aspekt të humbjes së vendeve të punës. Si rrjedhojë e kësaj, në këtë përgjigje gratë gjithashtu dominojnë edhe për nga aspekti i përgjigjes se ato sot jetojnë në kushte më të rënda ekonomike, krahasuar me periudhën para pandemisë.

Në këtë drejtim, 45.50% e grave të anketuara kanë deklaruar se gjendja e tyre ekonomike është më e keqe krahasuar me periudhën para pandemisë, ndërsa kështu janë përgjigjur edhe 42.10% e burrave të anketuar, po ashtu 3% e grave dhe 2.60% e burrave kanë deklaruar se gjendja e tyre ekonomike është shumë më e keqe. Sa i përket gjendjes ekonomike, me përgjigje as më mirë, e as më keq janë përgjigj 45.50 e grave dhe 47.40% e burrave, ndërsa 7.90% e burrave dhe 6% e grave të anketuara vlerësojnë se gjendja e tyre ekonomike tani është më e mirë se sa në periudhën para shfaqjes së pandemisë Covid 19.


5. Pandemia Covid 19 dhe dhuna në familje tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian

Dhuna në familje është një dukuri shumë negative në shoqërinë tonë dhe mbetet sfidë e shoqërisë dhe e institucioneve që atë ta luftojë deri në eliminimin e saj në tërësi. Dhuna në familje i ka karakteristikat e saj dhe është e lidhur ngushtë me gjendjen sociale dhe ekonomike. Paraqitja e pandemisë Covid 19 si pasojë direkte ka pasur edhe rritjen e rasteve të dhunës në familje, kjo së pari duke u nisur nga masat e Qeverisë për masat kufizuese në aspekt të lirisë së lëvizjes, e pastaj edhe nga pasojat tjera, e posaçërisht nga vështirësitet ekonomike të shfaqura nga pandemia.¹⁰

Se pandemia Covid 19 ka pasur ndikim direkt në rritjen e rasteve të dhunës në familje, tregohet edhe nga raportet vjetore të punës të prokurorisë së shtetit. Nga këto raporte shihet një rritje shqetësuese e rasteve të dhunës në familje nga viti në vit. Në grafikonin më poshtë janë të paraqitura statistikat e rasteve të dhunës në familje në vitet 2019, 2020 dhe 2021.

¹⁰ Për më shumë shih artikullin “Dhuna në familje – “epidemi” që u rrit gjatë pandemisë”, i qasshëm në: <https://www.koha.net/arberi/304211/dhuna-ne-familje-ndash-epidemi-qe-u-rrit-gjate-pandemise/>.

Rastet e dhunës në familje gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 - Prokuroria e Shtetit



Grafikoni 8: Rastet e dhunës në familje në Kosovë gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 – Prokuroria e Shtetit.¹¹


Në bazë të dhënave në grafikonin më lartë, vërehet një rritje shqetësuese e rasteve të dhunës në familje para shfaqjes së pandemisë Covid 19 dhe pas shfaqjes së saj. Përderisa në vitin 2019 para se të shfaqej pandemia, numri i rasteve të dhunës në familje ishte 1,353 raste, ky numër gjatë vitit 2020 shënon rritje për 767 raste, apo 36.17 % raste më shumë. Ky trend negativ ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021, ku kahasuar me vitin paraprak ka 546 apo 20.48% raste më shumë. Këto të dhëna padyshim që janë pasojë e pandemisë Covid 19, përkatësisht si rezultat i pasojave të pandemisë Covid 19, e të cilat kryesisht lidhen me gjendjen e rëndë ekonomike.

Është e rëndësishme të theksohet që institucionet e shtetit si policia, prokuroria dhe gjykatat në raportet e punës së tyre nuk i kanë të ndara rastet e dhunës në familje në aspekt të përkatësisë etnike, apo të ngjashme, por vetëm si tërësi. Për qëllime të analizës, nga institucionet relevante janë kërkuar të dhëna për rastet e dhunës në familje për vitet 2019, 2020 dhe 2021 në Komunën e Prizrenit, ku viktimi kanë qenë pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Fillimisht këto të dhëna janë kërkuar nga Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria Rajonale Prizren, sipas të dhënave të pranuara, vërehet një rritje e rasteve të dhunës në familje gjatë këtyre tri viteve në Komunën e Prizrenit, ku viktimi kanë qenë pjesëtarët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Të dhënrat e detajuara i gjeni në grafikonin më poshtë.

¹¹ **Burimi:** Raportet vjetore të punës të prokurorisë së shtetit, të qasshme në: <https://prokuroria-rks.org/psh/dokumente-publikime/108/165/665/665/>.

Numri i rasteve të denoncuara në polici për dhunë në familje gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, ku viktimi kanë qenë pjesëtarët e komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian nga Komuna e Prizrenit



Grafikoni 9: Numri i rasteve të denoncuara në polici për dhunë në familje gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, ku viktimi kanë qenë pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian nga Komuna e Prizrenit.¹²

Nga të dhënat në grafikon vërehet një rritje e konsiderueshme e rasteve të denoncuara për dhunë në familje nëse krahasohet viti 2019 që ishte para pandemisë, me vitet 2020 dhe 2021 si vite pas paraqitjes së pandemisë. Edhe pse gjatë vitit 2020 vërehet një rënje e lehtë, përkatësisht për 2 raste, mirëpo në vitin 2021 vërehet menjëherë një rritje ku nga 23 raste sa ishin në vitin 2019, përkatësisht 21 gjatë vitit 2020, kalon në 30 raste në vitin 2021. Të njëjtat të dhëna i posedon edhe Prokuroria Themelore në Prizren sa i përket kallëzimeve penale për dhunë në familje.¹³ Pra, pandemia Covid 19, sikurse në nivel vendi, gjithashtu edhe tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në Komunën e Prizrenit ka ndikuar direkt në rritjen e rasteve të dhunës në familje.


Lidhur me këtë çështje edhe nga Gjykata Themelore e Prizrenit janë kërkuar statistika lidhur me shqyrtimin e rasteve për dhunë në familje gjatë vitit 2019, 2020 dhe 2021, ku viktimi kanë qenë pjesëtarët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, mirëpo Gjykata nuk ka ofruar këto të dhëna duke potencuar se nuk i ndan lëndët për nga aspekti etnik, mirëpo janë ofruar të dhëna të përgjithshme për Komunën e Prizrenit. Nga këto të dhëna dëshmohet se në vitin 2019 janë shqyrtuar 104 lëndë, në vitin 2020 janë shqyrtuar 88 lëndë, ndërsa në vitin 2021 Gjykata Themelore e Prizrenit ka shqyrtuar 134 lëndë që kanë pasur të bëjnë me dhunën në familje.

Duke analizuar numrin e kallëzimeve penale në polici dhe prokurori, ku viktimi kanë qenë pjesëtarët nga komuniteti rom, ashkali apo egjiptian gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 dhe numrin e përgjithshëm të lëndëve të shqyrtuara nga Gjykata Themelore e Prizrenit gjatë këtyre viteve përfundohet se në një numër të madh të rasteve të dhunës në familje, viktima i përket komunitetit,

¹² **Burimi:** Përgjigja nëpërmjet e-mail nga Policia e Kosovës - Drejtoria Rajonale Prizren, datë: 03.08.2022.

¹³ **Burimi:** Përgjigja npërmjet e-mail nga Prokuroria Themelore e Prizrenit, datë 02.08.2022.

rom, ashkali apo egjiptian. Madje ky numër, përkatësish kjo përqindje e rasteve të dhunës në familje, ku viktimi janë pjesëtarët nga komuniteti rom, ashkali apo egjiptian është shumë më i lartë se pjesëmarrja e këtyre komuniteteve në numrin e përgjithshëm të popullsisë në Komunën e Prizrenit. Një krahasi të detajuar e gjeni në grafikonin 8.




Grafikoni 10: Përqindja (%) e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në papunësinë e përgjithshme të Komunës së Prizrenit dhe përqindja (%) në rastet e dhunës në familje gjatë vitit 2019, 2020 dhe 2021.¹⁴

Të dhënat në grafikonin 10 dëshmojnë se rastet e dhunës në familje në Komunën e Prizrenit në një pjesëmarrje shqetësuese kanë të bëjnë me komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Përderisa pjesëmarrja e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në popullsinë e Komunës së Prizrenit është vetëm 2.48%, sa i përket rasteve të dhunës në familje kjo pjesëmarrje shumëfishohet. Nga ky shumëfishim përfundohet se gati çdo i treti rast i dhunës në familje është nga komuniteti rom, ashkali apo egjiptian. Kjo është pasqyrë e qartë e gjendjes së këtij komuniteti, posaçërisht ajo sociale dhe ekonomike, e cila pastaj është e lidhur ngushtë edhe me dhunën në familje.

Gjatë zhvillimit të anketave, të anketuarit janë pyetur edhe lidhur me atë se në dy vitet e fundit a keni paraqitur ndonjë rast në polici, prokurori apo gjykatë për ndonjë veprer penale kundër jush apo ndonjë anëtarë të familjes tuaj, pastaj gjatë dy viteve të fundit a është shkaktuar ndonjë veprer penale kundër jush apo ndonjë anëtarë të familjes e të cilën nuk e keni deklaruar në organet përkatëse dhe atë se a keni dëgjuar në dy vitet e fundit për ndonjë rast të dhunës në familje i cili ka qenë i lidhur me kushtet e rënda ekonomike. Përgjigjet i gjeni në grafikonin më poshtë.

¹⁴ **Burimi:** Prokuroria Themelore Prizren, Gjykata Themelore Prizren dhe Policia Rajonale e Prizrenit.




Grafikoni II: Përgjigjet e të anketuarve lidhur me dhunën në familje.

Dhuna në familje si një dukuri shumë shqetësuese në shoqërinë tonë, është problematizuar edhe më tej si pasojë e pandemisë Covid 19. Këtë lidhshmëri të pandemisë Covid 19 dhe rritjen e rasteve të dhunës në familje e faktojnë edhe statistikat të cilat do të paraqiten në vazhdim të analizës. Sidoqoftë është edhe një fakt notor se në Kosovë shumica dërmuese e viktimate të dhunës në familje i përkasin gjinisë femërore dhe se një numër i rasteve të dhunës në familje as që denoncohet tek organet kompetente. Kjo vërehet edhe nga përgjigjet e dhëna në grafikonin më lartë. Përderisa vetëm 2.6% e burrave të anketuar kanë deklaruar se në dy vitet e fundit kanë paraqitur rast në institucionet përgjegjëse për dhunë në familje ku viktimi kanë qenë vetë ata apo ndonjë anëtarë i familjes së tyre, kjo përqindje tek gratë është më shumë se njëfish më e lartë, përkatësisht arrin në 6.10%.

Gjithashtu, përderisa të gjithë burrat e anketuar kanë mohuar se gjatë dy viteve të fundit është shkaktuar ndonjë vepër penale kundër tyre apo ndonjë anëtari të familjes e të cilën nuk e kanë denoncuar në organet përkatëse, e kundërtë është tek gratë, ku 3% e të anketuarve e kanë pohuar një gjë të tillë. Lidhur me pyetjen se në dy vitet e fundit a keni dëgjuar për ndonjë rast të dhunës në familje i cili ka qenë i lidhur me kushtet e rënda ekonomike 3% e grave dhe 2.60% e burrave të anketuar janë përgjigjur se po.

Sa i përket dhunës në familje, përveç statistikave të cilat i posedojnë institucionet kryesore si policia, prokuroria e gjykatat, të dhëna të vlefshme mbajnë edhe institucionet të cilat merren me mbrojtjen e viktimate të dhunës në familje. Për qëllime të analizës, janë marrë të dhëna nga Zyra Regionale për Mbrotjen e Viktimate të Dhunës në Familje dhe Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Komunën e Prizrenit, për të parë numrin e rasteve të pranuara në vitet përkatëse, ku viktimat kanë qenë si pasojë e dhunës në familje, dhe viktimat i përkasin komunitetit rom, ashkali apo egjiptian

Të dhënrat janë marrë për vitin 2019 si vit para se të shfaqej pandemia dhe vitet 2020 dhe 2021 si vite pas shfaqjes së pandemisë. Të dhënrat e ofruara nga këto dy institucione vërtetojnë se me shfaqjen e pandemisë Covid 19 ka ndryshuar dukshëm edhe numri i rasteve të pranuara nga këto dy institucione. Të dhënrat më të detajuara në aspekt numerik i gjeni në grafikonin më poshtë.



Grafikoni 12: Numri i rasteve të pranuara nga Zyra Regionale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve, ku viktima kanë qenë pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali apo egjiptian.¹⁵

Të dhënrat në grafikonin më lartë tregojnë ndryshimet në statistika lidhur me rastet e pranuara nga këto dy institucione para dhe pas shfaqjes së pandemisë Covid 19. Përderisa Zyra Regionale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje në Komunën e Prizrenit gjatë vitit 2019 kishte pranuar 10 raste nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, po aq raste kishte pranuar edhe në vitin 2020, ndërsa një rritje drastike shihet në vitin 2021 ku ky numër gati trefishohet krahasuar me vitin 2019. Edhe Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve, përderisa në vitin 2019, përkatësisht para shfaqjes së pandemisë kishte pranuar vetëm dy 2 raste që i përkisnin komunitetit rom, ashkali apo egjiptian, ndërsa në vitin 2020 ky numër gjashtëfishohet duke arritur në 11 raste, ndërsa në vitin 2021 në 9 raste.

Përfundimisht pandemia Covid 19, përkatësisht pasojat sociale dhe ekonomike të sajë janë të lidhura ngushtë edhe me dhunën në familje tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

¹⁵ Burimi: Përgjigjet e dërguara nëpërmjet e-mail nga Zyra Regionale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje datë 02.08.2022, dhe bisedë telefonike me znj. Shemsije Segdati, mbrojtëse e viktimave, datë 29.07.2022.

6. Pakos e Ringjalljes Ekonomike dhe ndikimi i saj tek komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian

Pandemia Covid 19 përveç efekteve lidhur me shëndetin e njerëzve, me vete solli dhe vazhdon të sjellë edhe shumë efekte tjera negative. Këto efekte negative posaçërisht kanë të bëjnë me aspektin ekonomik, ndërsa pasojat më të shumta i vuajnë qytetarët me të ardhura të ulëta, përkatësisht me kushte të rënda ekonomike. Pandemia gjithashtu vuri në pah se shumë institucionë publike, duke filluar nga shëndetësia, arsimi, siguria, e kështu me radhë nuk kanë kapacitete të mjaftueshme në mënyrë që të ballafaqohen me nevojat e qytetarëve dhe pasojat e pandemisë.

Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës në kuadër të ballafaqimit me pasojat ekonomike të pandemisë Covid 19, më 14.07.2021, nëpërmjet Vendimit Nr. 13/19, ka miratuar Pakon e Ringjalljes Ekonomike.¹⁶ Vetë emërtimi Pako e Ringjalljes Ekonomike do të thotë se si pasojë e pandemisë Covid 19, ekonomia edhe ashtu e brishtë e Republikës së Kosovës ka pësuar një “goditje”, dhe tash Qeveria me anë të masave të saj dëshiron që të njëjtën ta ringjallë. Duhet theksuar se kësaj pako i ka paraprirë Pako Emergjente Fiskale e vitit 2020.¹⁷

Me anë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Qeveria ka prezantuar gjithsej 5 masa, ku pastaj secila masë i ka edhe nënmasat e saj, me një numër total prej 26 nënmasa. Në tabelën më poshtë janë të paraqitura të gjitha masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Pako e Ringjalljes Ekonomike	
Masa	Nënmasa
MASA I Mbështetja e Punësimit 50,000.000€	I.1. Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë – 10 milionë Euro
	I.2. Mbështetja për të punësuarit e formalizuar – 10 milionë Euro
	I.3. Mbështetja e punësimit të grave – 5 milionë Euro
	I.4. Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë – 10 milionë Euro
	I.5. Trajnim i punësimit në TI – 5 milionë Euro
	I.6. – Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta – 5 milionë Euro
	I.7. Skema e granteve për zanatet – 5 milionë Euro
MASA II Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit 108,000.000€	2.1. Subvencionimi i kredive investive – 30 milionë Euro
	2.2. Mbështetje bizneseve për qasje në financa – 43 milionë Euro
	2.3. Investime në TI dhe Inovacion – 10 milionë Euro
	2.4. Mbështetja e Eksportit – 10 milionë Euro
	2.5. Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit – 10 milionë Euro
	2.6. Rikuperimi i hotelerisë dhe bizneseve të myllura – 5 milionë Euro
MASA III	3.1. Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin – 4 milionë Euro
	3.2. Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale – 17 milionë Euro

¹⁶ Shih, Vendimin Nr. 13/19, i datës 14.07.2021, i qasshëm në: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=43978>.

¹⁷ Për më shumë, shih vendimin dhe masat e Pakos Emergjente Fiskale, i qasshëm në:

<https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/05/Vendimi-per-Pakon-Emergjente-Fiskale-I.pdf>.

Mbështetja për familjen	3.3. Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale – 12 milionë Euro 3.4. Kuponë ushqimi për familjet në nevojë – 4 milionë Euro 3.5. Pagesa për lehonat e papuna – 3 milionë Euro 3.6. Mbështetja e likuiditetit familjar – 10 milionë Euro
50,000.000€	
MASA IV Mbështetja për publiken	4.1. Mbështetja për shëndetësinë – 53 milionë Euro 4.2. Mbështetja për Arsimin – 9 milionë Euro 4.3. Mbështetja e Kulturës dhe Sportit - 5 milionë Euro 4.4. Mbështetja e sigurisë – 10 milionë Euro 4.5. Mbështetja e mërgatës – 5 milionë Euro 4.6. Mbështetja e ndërmarrjeve publike – 30 milionë Euro
112,000.000€	
MASA V Investimi në infrastrukturë dhe ambient	N/A
100,000.000€	

Tabela I: Masat dhe nënmasat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike.¹⁸

Pako e Ringjalljes Ekonomike e ka një kosto totale 420 milion euro, ku prej tyre 190 milion euro janë të finançuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ndërsa pjesa tjeter prej 230 milion euro janë të finançuara nga huamarrja.

7. Ndikimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian

Pandemia Covid 19, përkatësisht pasojat e sajë kanë prekur dhe vazhdojnë t'i prekin shtresat e popullsisë, përkatësisht qytetarët dhe familjet me të ardhura të ulëta për kokë banori. Kjo përfaktin se përvèç shkurtimit të vendeve të punës, në të njëjtën kohë ekonoma e Kosovës është ballafaquar edhe me rritjen e çmimeve të produkteve bazë.¹⁹ Duke e ditur që një numër i konsiderueshëm i pjesëtareve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, përkatësisht i familjeve të tyre jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe me një shkallë shumë të lartë të papunësisë, padyshim që ndër më të prekuri janë qytetarët nga këto komunitete.

Në vazhdim është analizuar ndikimi i secilës masë dhe nënmasë nga Pako e Ringjalljes Ekonomike, tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Vlerësimi ka për qëllim që secilën masë ta shpjegoj se a ka ndikim të plotë, të pjesshëm, të pakët, apo nuk ka fare ndikim tek pjesëtaret e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

¹⁸ Burimi: Vendimin Nr. 13/19, i datës 14.07.2021, i qasshëm në: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=43978>.

¹⁹ Shih, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, i qasshëm në: <https://ask.rks-gov.net/media/6856/indeksi-i-harmonizuar-i-%C3%A7mimeve-t%C3%AB-konsumit-ih%C3%A7k-maj-2022.pdf>.

7.1. Masa I - Mbështetja e Punësimit - 50 milionë Euro

Duke pasur parasysh që ndër mekanizmat kryesor për ringjallje ekonomike është padyshim rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e tyre të punës dhe rritja e vendeve të punës, sigurisht që kjo masë hynë në rendin e parë edhe për nga rëndësia. Me anë të kësaj mase, Qeveria synon që të rikthej në punë ata që kanë humbur vendin e tyre të punës si pasojë e pandemisë Covid 19, të rris formalizimin e kontratave të punës për punëtorët e pa formalizuar, të mbështes punësimin e grave, të rinjve, mbështetjen e punësimit të personave me nevoja të veçanta, e kështu me radhë.

Në vazhdim, është paraqitur secila nënmasë nga masa I dhe ndikimet e tyre tek pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë - Pjesëmarrja e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, është shumë e ulët në tregun e punës, në fakt, nëse marrim statistika nga Komuna e Prizrenit, atëherë vetëm katër romë dhe ashkali punojnë në administratën e komunës, përkatesisht një burrë romë është i punësuar si shërbypes civil, dy burra romë dhe një grua ashkali punojnë si personel teknik dhe përkrahës. Përveç kësaj, një burrë egjiptian, tre burra romë dhe një grua rome, janë të punësuar në sektorin e shëndetësisë si personel teknik, ndërsa 16 burra romë, pesë burra ashkali dhe një burrë egjiptian janë të punësuar në kompaninë lokale të shërbimeve publike “Ekoregjioni”, që në total janë 31 qytetarë.²⁰

Kujtojmë, që Komuna e Prizrenit për vitin 2022 të punësuar që marrin pagë nga buxheti komunal i ka të regjistruar gjithsej 3,175 persona, ndërsa nga ky numër vetëm 31 prej tyre apo 0.97% u përkasin komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian.²¹ Gjithashtu, edhe qasja në tregun privat të punës mbetet sfidë për qytetarët nga këto komunitete. Në këtë drejtim, kjo masë ndikimin në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian e ka pothuajse të padukshëm, për faktin se shkalla e papunësisë tek këto komunitete është shumë e lartë, andaj vështirë se përfitojnë nga kjo masë.

Mbështetja për të punësuarit e formalizuar - Edhe kjo masë përfshin kategorinë e qytetarëve që më së paku i përfshinë qytetarët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo masë ka për qëllim formalizimin e punëtorëve të cilët faktikisht punojnë, mirëpo juridikisht nuk janë të regjistruar si të punësuar. Ndjekimi i vogël i kësaj mase argumentohet me faktin se që nga fillimi i implementimit të kësaj mase, e deri në muajin prill të vitit 2022, janë formalizuar gjithsej 2,168 punëtorë.²² Sidoqoftë, këtu nuk mund të përfundojmë që kjo masë nuk ka ndikim edhe tek qytetarët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, mirëpo ndikimi është shumë simbolik, për

²⁰ Shih, “Pasqyrë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës”, OSCE, faqe 78, i qasshëm në: https://www.osce.org/files/f/documents/c/c/443590_2.pdf.

²¹ Për më shumë, lidhur me numrin e të punësuarve në Komunën e Prizrenit, shih Qarkoren Buxhetore 2022/02, e datës 05.08.2021, e qasshme në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FB0F91E6-C7E7-40E8-A808-BEF2C3975FA7.pdf>.

²² Për më shumë shih lajmin nga portal Front Online, sipas deklaratës së zëdhënëses së ATK-së, znj. Valentina Bytyqi-Sefa, i qasshëm në: <https://frontonline.net/56formalizimi-i-punetoreve-ne-atk-registrohen-mbi-2-mije-punetore/>.

faktin se ky komunitet është shumë pak i kyçur në tregun e punës, si në atë formal, asht edhe në atë jo formal.

Mbështetja e punësimit të grave - Punësimi i grave mbetet sfidë për institucionet e Republikës së Kosovës, sipas statistikave të fundit, pjesëmarrja e grave në tregun e punës është vetëm 16%, apo më pak se çdo e gjashta grua është e punësuar.²³ Në bazë të të dhënave të Zyrës për Çështje të Komuniteteve, papunësia tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian sillet nga 90% deri në 100%.²⁴ Në këto rrethana është e nënkuftueshme se si qëndrojnë statistikat tek punësimi i grave nga këto komunitete, ku papunësia në total është në mes të 90% deri 100%, ndërsa në nivel të Republikës së Kosovës papunësia e grave është më shumë se 84%.

Tutje, sipas kësaj mase, për secilën grua që nuk ka qenë e punësuar në tre muajt e fundit, e që punësohet, do të subvencionohet 50% të pagës për tre muajt e parë, deri në maksimumin prej 150 euro në muaj. Për kundër që kjo masë është një mënyrë për rritjen e punësimit tek gratë, ajo është vështirë e zbatueshme posaçërisht duke pasur parasysh faktin se gratë duhet të angazhohen vetë në sigurimin e vendit të punës, mungesa e kualifikimeve të caktuara shkollore e profesionale, e kështu me radhë.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh faktin se pjesëtarët e këtyre komuniteteve ballafaqohen me shkallë të ulët të pjesëmarrjes në arsim si dhe fenomeni i braktisjes së shkollimit.²⁵ Sipas statistikave, në Komunën e Prizrenit në vitin shkollor 2020/2021, në shkollë të mesme të lartë figura një vetëm 30 nxënës nga komuniteti rom, ndërsa nga komuniteti ashkali dhe egjiptian nuk figuron asnjë nxënës.²⁶ Përfundimisht kjo masë nuk përjashton apo kufizon gratë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, mirëpo qasja e tyre në tregun e punës është e kufizuar duke filluar nga aspekti diskriminues deri tek mos kualifikimi i duhur për vendin e caktuar të punës, duke shkaktuar përjashtimin social të tyre.²⁷

Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë - Kjo masë ka për qëllim punësimin e të rinjve. Masa fillimisht parasheh përmirësimin e edukimit profesional, zgjerimin e mundësive për të mësuar nga praktika, ofrimin e edukimit, profesional, e kështu me radhë. Kjo masë nuk është zbatuar plotësisht, madje deri në gusht 2022 është implementuar vetëm një projekt dhe atë me Universitetin e Prishtinës. Për këtë skemë kanë aplikuar vetëm 63 persona, ndërsa kriter kryesor ka qenë “Përfundimi i studimeve në Universitetit të Prishtinës në fushën e mirëqenies sociale”.²⁸

²³ Shih, Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP), TM2 2021, e qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anketa-e-fuqise-punetore-afp-tm2-2021>.

²⁴ Për më shumë shih, Zyra për Çështje të Komuniteteve, në kuadër të Zyrës së Kryeministrat, e qasshme në: <https://zck-ks.net/?page=1,45>.

²⁵ Shih raportin: “Arsimimi i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës”, i qasshëm në: <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2022/01/Arsimimi-i-komuniteteve-rom-ashkali-dhe-egjiptian-n%C3%AB-kosov%C3%AB-verzioni-final.pdf>.

²⁶ Shih statistikat e arsimit në Kosovë për vitin 2020/2021, ASK, i qasshëm në: https://ask.rks-gov.net/media/6292/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB_2020-21.pdf.

²⁷ Për më shumë, shih raportin e Civil Rights Defenders, me titull : “Muri i Antigjipsizmit”, i qasshëm në: <https://crd.org/wp-content/uploads/2018/02/The-Wall-of-Anti-Gypsyism-%E2%80%93-Roma-in-Kosovo-Alb.pdf>.

²⁸ INDEP, Raport përbledhës i monitorimit të zbatimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, i qasshëm në: <https://indep.info/wp-content/uploads/2022/07/Raporti-i->

Pjesëmarrja në studime para universitare është shumë e ulët tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, e mos të flasim për studimet universitare, andaj kjo masë apo skemë vështirë që prekë pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian. Sidoqoftë, për këtë skemë, në Komunën e Prizrenit ka aplikuar vetëm një person.²⁹ Në vazhdim, mbetet në përgjegjësinë e Agjencisë së Punësimit të Republikës ë Kosovës për zbatimin e kësaj mase, mirëpo kjo masë nuk përfshin komuniteti në fjalë për shkak të kritereve të larta shkollore, dhe të njëjtit janë pothuajse të përjashtuar nga kjo skemë.

Trajnimi dhe punësimi në TI - Kjo masë ka për qëllim ofrimin e kuponëve për të rinjtë e moshës 18 deri 24 vjeç, për ndjekjen e kurseve profesionale në fushën e teknologjisë informative. Në këtë drejtim, Ministria e Arsimit, pas shpalljes së konkursit ka publikuar rezultatet për këtë masë, ku përfitues të saj janë 943 maturantë të shkollave të mesme në gjithë Republikën e Kosovës. Nga Komuna e Prizrenit kanë përfituar gjithsej 389 maturantë, apo vetëm 4.13% të të gjithë përfituesve.³⁰ Gjithashtu, është dhënë mbështetje financiare edhe për 552 studentet vajza/gra në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës.³¹

Edhe kjo masë, përkundër që nuk ka ndonjë kriter i cili do të përjashtonte të rinjtë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, sidoqoftë duke u nisur nga pjesëmarrja e tyre në asimin e mesëm të lartë që nuk është më shumë se 31%, atëherë edhe kjo masë do të ketë pak ndikim tek pjesëtarët e këtyre komuniteteve.

Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta - Kjo masë ka për qëllim përkrahjen dhe mbështetjen në punësim të personave me nevoja të veçanta. Kjo masë është projektuar në atë formë që e njëjta të zbatohet me ndihmën e organizatave të shoqërisë civile. Organizatat do të ndërmjetësojnë në trajnimin e personave me nevoja të veçanta, këta persona do të trajnohen në bizneset e caktuara dhe nga kjo masë, për periudhën kohore prej tre deri gjashtë muaj, të trajnuarit (personat me nevoja të veçanta) do të përfitojnë nga 170 euro në muaj, ndërsa bizneset që ofrojnë mundësi për trajnime përfitojnë nga 100 euro në muaj. Në muajin mars 2022 është publikuar edhe vendimi për mënyrën e përzgjedhjes së OQ-ve.³³ Pranimi i aplikuarve ka filluar në qershor, ndërsa ende nuk ka njoftim zyrtar për përzgjedhje të përfituesve.

Kjo masë është shumë e rëndësishme, nevojat për përgatitje profesionale dhe rritje të punësimit të personave me nevoja të veçanta janë jashtëzakonisht të mëdha. Kjo masë prekë edhe

[Monitorimit_3_ALB_Final.pdf?fbclid=IwAR18DMG3Emvh6sy5pbC8taDpV6HLNsosLwBfrFqzDrLBX75hBUY8vNszg&fs=e&s=cl](#).

²⁹ Po aty, tabela numër 1.

³⁰ Për më shumë, shih Vendimin Nr. 018/358, për shpalljen e përfituesve, i qasshëm në: <https://spinp.agency/masht/wp-content/uploads/2022/05/vendimi-me-nr-01b-3579-per-perfitusve-te-subvencioneve-te-maturantve-per-ndekjen-e-kurseve-ne-fushen-e-ti.pdf>.

³¹ Për më shumë, shih Vendimin Nr. 01B/359, për shpallen e përfituesve vajza/gra, i qasshëm në:

<https://spinp.agency/masht/wp-content/uploads/2022/05/vendimi-me-nr-01b-3578-te-perfitusve-te-mbeshtetjes-financiare-per-studentet-vajza-gra-ne-fushat-e-stem.pdf>.

³² Shih reportin: "Arsimimi i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës", i qasshëm në: <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2022/01/Arsimimi-i-komuniteteve-rom-ashkali-dhe-egjiptian-n%C3%AB-kosov%C3%AB-verzioni-final.pdf>.

³³ Për më shumë, shih Vendimin Nr.541/2022, i qasshëm në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/01415B70-161E-4B60-ADD1-35F67326A71E.pdf>.

komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, mbetet vetëm të realizohet në praktikë, në mënyrë që të kemi rezultate të kënaqshme dhe në përputhje me objektivat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Skema e granteve për zanatet - Kjo skemë ka për qëllim adresimin e shkallës së lartë të papunësisë në vend si dhe aftësimin profesional në zanate. Kjo nënkupton dhënien e granteve për vetëpunësim të gjithë ata që janë të gatshëm të mësojnë aftësi të reja, për të cilat do të certifikohen. Vlera e këtyre granteve arrin shumën deri në 3,000 euro për person, ku granti do të mbulojë blerjen e pajisjeve dhe themelimin e biznesit, të gjitha këto pas përfundimit të trajnimit me sukses dhe certifikimit. Kjo masë është shumë e rëndësishme dhe përfshin plotësisht edhe qytetarët që i përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Mirëpo, nuk ka asnje njoftim, a veprim i cili dëshmon që kjo skemë ka filluar të zbatohet dhe e njëjtë bënë pjesë ndër skemat e vetme që ende nuk kanë filluar të zbatohen nga Qeveria.³⁴

7.2. Masa 2 - Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit – 108 milionë Euro

Në kuadër të pasojave të shumta të pandemisë Covid 19, ndër pasojat më të mëdha ishin ato ekonomike, kjo përfaktin se me paraqitjen e pandemisë shumë biznese u mbyllën apo shkurtuan vendet e punës, dhe këto pasoja përveç që ishin të menjëherëshme në ekonominë e Kosovës, ato vazhdojnë të janë problematikë edhe sot. Përveç kësaj, Kosova u ballafaqua edhe me kriza të furnizimit me ushqime bazë, e gjithë kjo duke ju atribuar mungesës së prodhimtarisë së nevojshme nga ana e bizneseve dhe me theks të veçantë të bujqësisë. Për ta përforcuar prodhimtarinë vendore, në kuadër të kësaj mase, Qeveria ka prezantuar 6 nënmasa.

Subvencionimi i kredive investive - Sipas kësaj mase, me qëllim të mundësimit të investimeve të reja, të gjitha bizneset prodhuase dhe përpunuese do të mbështeten nëse marrin kredi. Kjo masë prek fare pak, përfaktin se këto komunitete nuk posedojnë numër të kënaqshëm të bizneseve, përkatesisht tek këto komunitete kemi të bëjmë me shkallë të papunësisë prej 90 deri 100%. Andaj, kjo masë si e tillë nuk është e drejtuar kundrejt këtyre komuniteteve.

Mbështetje bizneseve për qasje në financa - Edhe kjo masë, si ajo më lartë është e koncentruar direkt në biznese dhe nuk ka pothuajse fare ndikim në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, e gjithë kjo bazuar në faktet e cekura në masën më lartë.

Investime në TI dhe Inovacion - Gjithashtu edhe kjo masë ka për qëllim përkrahjen e bizneseve në fushën e teknologjisë informative, njëjtë si në dy masat paraprake, as kjo masë nuk ndikon në pjesëtarët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

³⁴ Lidhur me mosbatimin e kësaj skeme, shih edhe INDEP, Raport përbledhës i monitorimit të zbatimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, i qasshëm në: https://indep.info/wp-content/uploads/2022/07/Raporti-i-Monitorimit_3_ALB_Final.pdf?fbclid=IwAR18DMDg3Emvh6sy5pbC8taDpV6HLNsosLwBfrFqzDrLBX75hBUY8vNszg&fs=e&s=cl

Mbështetja e eksportit - Me këtë masë do të mbështeten bizneset prodhuese dhe eksportuese në rritje të cilësisë dhe marrjen e certifikimeve të nevojshme. As kjo masë e Qeverisë nuk ndikon tek pjesëtaret e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Ringallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit – Me anë të kësaj mase do të investohet në krijimin e infrastrukturës dhe parakushteve për zhvillimin e agroturizmit nëpër fshatrat. Kjo përfshin edhe mbështetjen për investime që do të mundësojnë shndërrimin e shtëpive të fshatit në bujtina që mund të presin mysafirë. Duhet theksuar që kjo masë përfshin fare pak për të mos thënë aspak komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo për faktin se pjesa më e madhe e këtij komuniteti jetojnë nëpër qytete, e pak nga ta nëpër fshatra, ndërsa për të drejtat pronësore të tyre në prona të paluajtshme nuk ka fare statistika.

Nëse marrim statistikat në Komunën e Prizrenit, nga 2,899 qytetarë të komunitetit rom, 2,666, apo 91.96% jetojnë në qytetin e Prizrenit, përkatesisht në zonën urbane, pastaj nga 1,350 qytetarë të komunitetit ashkali, 742, apo 54.96% jetojnë në zonën urbane, dhe nga 168 qytetarë të komunitetit ashkali, 58, apo 34.52% e tyre gjithashtu jetojnë në zonën urbane.³⁵ Në përgjithësi, 78.46 % e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit jetojnë në zonën urbane. Rrjedhimisht kjo masë indirekt ndikon në këtë komunitet.

Rikuperimi i hotelerisë dhe bizneseve të mbyllura - Kjo masë synon mbështetjen e bizneseve të cilat kanë pësuar më së shumti gjatë pandemisë dhe për shkak të mbylljes nuk kanë arritur të kryejnë detyrimet që kanë pasur ndaj institucioneve shtetërore dhe bankave. Kjo masë nuk ka ndikim tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

7.3. Masa 3 - Mbështetja për familjen – 50 milionë Euro

Pandemia Covid 19 shkaktoi pasoja të mëdha edhe në familjet në Republikën e Kosovës, pasojat më të mëdha sigurisht që ndihen tek familjet nga grupet e cenesueshme të shoqërisë, ku padyshim këtu bëjnë pjesë edhe familjet nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Si pasojë e pandemisë Covid 19, shumë familje u vendosën në situatë të vështirë ekonomike dhe intervenimi i shtetit në këtë drejtim ishte i domosdoshëm. Andaj, duke u nisur nga kjo, Qeveria ka miratuar masën mbështetja për familjen, së bashku me 6 nënmasa.

Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin - Kjo masë përfshin të gjithë popullsinë, përkatesisht familjet që kanë humbur pjesëtarin e familjes gjatë pandemisë Covid 19. Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, përkatesisht 3,178 qytetarë kanë humbur jetën prej shfaqjes së pandemisë, deri më sot.³⁶ Nga kjo masë kanë përfituar gjithsej 2,930 familje, mirëpo

³⁵ Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, regjistrimi i popullësisë, viti 2011, të dhënat e qasshme në:
https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Census%20population_Census%202011_3%20By%20Settlements_20%20Popullsia%20e%20komun%c3%abs%20s%c3%ab%20Prizrenit%20sipas%20vendbanimit/censusetn20.px/table/tableViewLayout1/.

³⁶ Shih reportin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, datë 08.08.2022, i qasshëm në:
https://datastudio.google.com/embed/u/0/reporting/2e546d77-8f7b-4c35-8502-38533aa0e9e8/page/MT0qb?fbclid=IwAR1rL_YTIdQtCvn5DbJp6KCHy6IDi6oX_MsW_DSZ-iZ2OgP0ffMjsfKpfHc.

nuk ka statistika lidhur me nacionalitetin e viktimateve. Përfundimisht kjo masë përfshinë plotësisht edhe pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale - Kjo masë ka për qëllim mbështetjen e pensionistëve dhe familjeve me asistencë sociale, përkatësisht qëllimi i masës eshtë që asnjë pension të mos jetë nën 100 euro, si dhe mbështetja për familjet që pranojnë asistencë sociale me pagesë 30% mbi nivelin e rregullt. Në këtë drejtim, kjo masë ndikon në mënyrë të barabartë tek të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe si e tillë paraqet ndikim direkt edhe tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Nëse marrim statistikat e familjeve në asistencë sociale në Komunën e Prizrenit, rezulton se nga 786 familje sa janë në asistencë sociale, 124, apo 15.77% janë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.³⁷

Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale - Kjo masë ka për qëllim që në bashkëpunim me Bankën Botërore, të fillohet një reformë në skemën për asistencës sociale, me qëllim zgjerimin e saj për të përfshirë më shumë familje në nevojë. Në dhjetor të vitit 2021 eshtë nënshkruar marrëveshja për “Projektin e Reformës së Sistemit të Ndihmës Sociale në Kosovë” në mes të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve dhe Bankës Botërore.³⁸ Duke u nisur nga nevoja e vazhdueshme dhe pjesëmarrja aq e madhe e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian për asistencë sociale, kjo reformë eshtë e mirëseardhur dhe ndikon indirekt edhe tek këto komunitete.

Kuponë ushqimi për familjet në nevojë - Kjo masë ka për qëllim që në bashkëpunim me UNDP-në dhe me financim të BE-së, 7,500 familjeve më në nevojë t'u shpërndahen kuponë ushqimi në vlerë prej 50 euro. Sipas pakos parashihet që të përfitojnë edhe për rrëth 3,000 familje tjera nga komunitetet jo-shumicë, me mbështetje të IOM-it. Kjo masë ndikon direkt tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, për shkak që një numër i madh i familjeve janë nën asistencë sociale dhe kanë nevojë për ndihma të tillë.

Pagesa për lehonat e papuna - Në kuadër të kësaj skeme, të gjitha lehonat që nuk punojnë, do të përfitojnë mbështetje në nivelin e pagës minimale për 6 muaj me radhë. Deri në korrik të vitit 2022 nga kjo masë kanë përfituar gjithsej 19,753 lehona.³⁹ Edhe në këtë masë në mënyrë plotësisht të barabartë përfitojnë edhe gratë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Mbështetja e likuiditetit familjar - Kjo masë ka për qëllim adresimin likuiditetit familjar për shkak të vështirësive ekonomike që lidhen me pandeminë Covid 19. Me këtë masë do të subvencionohen kreditë për konsum deri në 3,000 euro. Qëllimi ka qenë që shumë familje të mbyllin bilancet e kredit kartelave që kanë interesa shumë të larta, dhe njëkohësisht të përgatiten për vjeshtën e vitit 2021, duke pasur likuiditetin e nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve sezionale. Pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian qasjen në kredi e kanë të vështirë sepse shumica nga ta nuk kanë një vend të punës, dhe të njëjtë jetojnë në vështirësi të

³⁷ Burimi: Të dhënat nga Qendra për Punë Komuna e Prizrenit, këto të dhëna janë siguruar nëpërmjet kërkesës për qasje në dokumente publike të datës 28.07.2022. Shih, gjithashtu statistikat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, <https://ask.rks-gov.net/media/6928/statistikat-e-mir%C3%ABrqenes-sociale-qershori-2022.pdf>.

³⁸ Për më shumë shih njoftimin për marrëveshje, i qasshëm në: <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1141>.

³⁹ Për më shumë shih artikullin, i qasshëm në: <https://shqip.com/murati-164-mije-femije-e-19-mije-lehona-kane-pranuar-shtesa-qe-nga-shtatori-i-vitit-te-kaluar/>.

vazhdueshme ekonomike dhe për pasojë nuk kanë qasje të kënaqshme në kredi. Në këtë drejtim, tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, kjo masë ndikon pak për të mos thënë fare.

7.4. Masa 4 – Mbështetja për publikën – 112 milionë Euro

Pasojat e pandemisë kanë qenë dhe janë shumë dimensionale dhe për rrjedhojë kanë sfiduar dhe shfaqur dobësitë edhe tek sistemet e shërbimeve publike të cilat në Republikën e Kosovës. Posërish sistemin shëndetësor, arsimor, ndërmarrjet publike, e kështu me radhë. Andaj, kjo masë tenton ringjalljen ekonomike edhe të institucioneve të cilat ofrojnë shërbime të rëndësishme publike.

Në vazhdim janë të paraqitura secila nën masë veç e veç dhe ndikimi i tyre në pjesëtaret e komunitetit rom, ashkal dhe egjiptian.

Mbështetja për shëndetësinë - Kjo masë ka për qëllim sigurimin e vaksinave kundër pandemisë Covid 19, përkatesisht 40 milion euro, pastaj 8 milionë euro tjera janë dedikuar për blerjen e barnave esenciale, si dhe 5 milion euro për specializantët e rinj. Kjo masë i referohet sistemit shëndetësor dhe për rrjedhojë nuk ka ndonjë ndikim të caktuar tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Mbështetja për Arsimin - Qëllimi i kësaj mase është të mundësojë mbulimin e hendekut të krijuar në të hyrat vetanake të universiteteve publike gjatë kohës së pandemisë, do të mundësojë blerjen e teksteve mësimore për nxënësit, si dhe do të mundësojë 1 milionë euro ndarje për bursa për studentët që studiojnë fushat e shkencave, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës. Edh kjo masë nuk ka ndonjë ndikim të caktuar tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Mbështetja e Kulturës dhe Sportit - Kjo masë ka për qëllim mbështetjen e ngjarjeve dhe projekteve kulturore të cilat vënë në pah artistët e rinj dhe krijojnë mundësi të promovimit të tyre. Njësoj mbështetje do të ketë edhe për sportin, duke mundësuar organizimin e turneve dhe ngjarjeve tjera sportive. Edhe kjo masë, si dy masat tjera më lartë nuk kanë ndonjë ndikim të caktuar tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Mbështetja e sigurisë - Kjo masë ka për qëllim avansimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës drejt një ushtrie moderne që mundëson përbushjen e misionit të saj, duke mbështetur pagesa për blerjen e pajisjeve dhe mjeteve ushtarakë. As kjo masë nuk ka ndonjë ndikim tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Mbështetja e mërgatës - Kjo masë ka për qëllim mbulinin e kostos së reduktuar të polisës kufitare për të gjithë mërgimtarët që vijnë në Kosovë, deri sa të zgjidhim përfundimisht çështjen e Kartonit të Gjelbër. Edhe kjo masë nuk ka ndonjë ndikim të caktuar tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian dhe kjo masë si e tillë nuk ka të bëjë aspak me ringjallje ekonomike.

Mbështetja e ndërmarrjeve publike - Qëllimi i kësaj mase është subvencionimi i ndërmarrjeve publike qendrore dhe lokale të cilat janë futur në vështirësi financiare si pasojë e pandemisë Covid 19. Edhe kjo masë nuk ka ndonjë ndikim të caktuar në pjesëtaret e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

7.5. Masa 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient – 100 milionë Euro

Kjo është masa e fundit në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike e cila kap një vlerë prej 100 milion euro. Masa në fjalë parasheh investime në projekte strategjike që kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturë rrugore e hekurudhore, si dhe me investime në ruajtjen e ambientit. Sipas vlerësimeve ko masë ende nuk ka filluar të jetësohet për të parë se ku saktësish do të investohet.⁴⁰ Sidoqoftë, kjo masë ashtu siç është parashikuar pa dyshim që në mënyrë indirekte ndikon edhe tek pjestarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Vlerësimi i ndikimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian					
Masa	Nënmasa	Ndikimi tek komuniteti rom, ashkali, egjiptian			
		Ndikim i plotë	Ndikim i pjesshëm	Ndikim i pakët	Nuk ka ndikim
I	1			✓	
	2			✓	
	3			✓	
	4			✓	
	5			✓	
	6	✓			
	7	✓			
II	1				✓
	2				✓
	3				✓
	4				✓
	5			✓	
	6				✓
III	1	✓			
	2	✓			
	3		✓		
	4	✓			
	5	✓			
	6			✓	
IV	1				✓
	2				✓
	3				✓
	4				✓
	5				✓
	6				✓
V	1		✓		
Gjithsej	26	6 nga 26	2 nga 26	7 nga 26	11 nga 26
		23.07%	7.70%	26.93%	42.30%

Tabela 2: Vlerësimi i ndikimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Nga të dhënat në tabelën më lartë, përfundohet se nga 26 masa, përkatësisht nënmasa të Qeverisë, vetëm 6 prej tyre, apo 23.07% ndikojnë plotësisht edhe tek pjesëtarët e komunitetit

⁴⁰ Për më shumë, shih: INDEP, Raport përmbledhës i monitorimit të zbatimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, i qasshëm në: https://indep.info/wp-content/uploads/2022/07/Raporti-i-Monitorimit_3_ALB_Final.pdf?fbclid=IwAR18DMDg3Emvh6sy5pbC8taDpV6HLNsosLwBfrFqzDrLBX75hBUY8vNszg&fs=e&s=cl.

rom, ashkali dhe egjiptian, 2 prej tyre, apo 7.70% ndikojnë pjesërisht, pastaj 7 nënmasa apo 26.93% kanë ndikim të pakët, ndërsa 11 masa apo 42.30% nuk kanë asnjë ndikim në pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Qeveria e Kosovës nuk e ka vendosur fare në konsultim publik, ashtu siç është e obliguar me dispozita ligjore.⁴¹ Mos vendosja në konsultime, përveç se dëshmon një jo transparencë të Qeverisë, në të njëjtën kohë kemi pasojën që mbi 42% e masave nuk prekin fare pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, apo vetëm 23.07% e tyre ndikojnë plotësisht tek pjesëtarët e këtyre komuniteteve.

Është e rëndësishme të theksohet dhe madje është edhe mjaftë shqetësues fakti se vetëm 2 nga 26 masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike u drejtohen direkt grave, përkundër që gjendja e tyre ekonomike llogaritet të jetë shumë më vështirë se e burrave. Kjo duke u bazuar edhe në shkallën e papunësisë tek gratë, ku llogaritet të jetë mbi 80%.⁴² Në fakt nga gjithsej 420 milion euro të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, vetëm 8 milion, apo 1.9% e këtij buxheti i drejtohet direkt grave.

Problem në vete mbetet informimi i duhur i qytetarëve dhe në këtë drejtim edhe i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike dhe masat e saj. Në këtë drejtim, nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve është kërkuar informacion për mënyrat dhe format e informimit publik që Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave Punës dhe Transfereve ka aplikuar për informimin e qytetarëve lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike.⁴³ Nga përgjigja e Ministrisë, dëshmohet se Qeveria nuk ka përdorë fushatë të mjaftueshme të informimit të qytetarëve lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike.

Në fakt, kjo Ministri është mjaftuar vetëm me disa lajme në web faqe, disa shkrime të mediave online si dhe me konferencat për media të përfaqësuesve të Qeverisë ku kanë folur për këtë pako, apo pjesëmarrja e tyre nëpër emisione të ndryshme.⁴⁴ Kjo mënyrë e informimit nuk siguron që secili qytetarë, e posaçërisht ata që kanë nevojë dhe kundrejt të cilëve është shpallë masa e caktuar, përfitojnë nga Pako e Ringjalljes Ekonomike. Rrjetim i kujdeset që qytetarët e Kosovës, të jenë të mirë informuar lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, duke u siguruar që përfitues do të jetë secili qytetarë, a biznes nga i cili është drejtuar masa e caktuar. Pako të tillë kërkojnë mënyra të shumta informimi, si për nga aspekti i ekzistimit të një pako të tillë, gjithashtu edhe në drejtim të lehtësimit lidhur me mënyrën se si qytetarët të aplikojnë, në mënyrë që të jenë përfitues.

⁴¹ Shih, Rregulloren (QRK) NR. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>.

⁴² Për më shumë shih, Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), për tremujorin e tretë (TM3) 2021, e qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anketa-e-fuqise-punetore-afp-tm3-2021>.

⁴³ Kërkësë për qasje në dokumente publike, datë 11.08.2022.

⁴⁴ Burimi: Përgjigja sipas kërkësës për qasje në dokumente publike, datë 22.08.2022.

8. Gjetjet kryesore

- Pandemia Covid 19 ka prekur të gjithë popullsinë e Kosovës, mirëpo me theks të veçantë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, për shkak të kushteve të vështira sociale dhe ekonomike.
- Ndihmat shtetërore karshi pandemisë Covid 19 nuk kanë mbërritur në adresë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, nga përgjigjet në anketa rezulton se vetëm 12.7% prej tyre kanë pranuar ndihma nga niveli lokal apo ai qendror.
- 7% e qytetarëve të anketuar e kanë humbur vendin e tyre të punës si pasojë e pandemisë Covid 19, ndërsa 19.7% e të anketuarve kanë deklaruar se një anëtarë i familjes së tyre ka humbur vendin e punës si pasojë e pandemisë Covid 19.
- 9.10% e grave dhe 5.30% e burrave të komunitetit rom ashkali dhe egjiptian kanë deklaruar se kanë humbur vendin e punës si pasojë e pandemisë Covid 19.
- Si pasojë e humbjes së vendit të punës dhe vështirësive ekonomike gjatë vitit 2020 dhe 2021 ka një rritje të theksuar të numrit të qytetarëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian që i janë drejtuar Agjencisë së Punësimit të Kosovës për të kërkuar një vende pune.
- 61.5% e qytetarëve të anketuar nuk e dinë se ekziston Agjencia e Punësimit, ndërsa 20% prej tyre nuk besojnë se kjo agjenci mund t'i punësoj.
- 48.5% e grave dhe 44.70% e burrave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian deklarojnë se gjendja e tyre ekonomike është më e keqe, krahasuar me periudhën para pandemisë Covid 19.
- Me shfaqjen e pandemisë, në Kosovë është rritur edhe numri i rasteve të dhunës në familje. Pandemia Covid 19 ka ndikuar direkt në rritjen e rasteve të dhunës në familje edhe tek komuniteti rom, shkali dhe egjiptian.

- Përderisa komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit përfaqësojnë vetëm 2.48% të popullsisë, në statistikat vjetore të dhunës në familje kjo përqindje shumëfishohet, duke kaluar deri mbi 26%.
- 6.10% e grave nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian kanë deklaruar se gjatë dy viteve të fundit ato, apo ndonjë anëtarë i familjes së tyre ka qenë subjekt i dhunës në familje, përderisa 3% e tyre kanë deklaruar se këtë nuk e kanë denoncuar në organet përgjegjëse.
- Rritjen e rasteve të dhunës në familje tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian si pasojë e pandemisë Covid 19 e dëshmojnë edhe statistikat e Zyrës Regionale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve, ku statistikat janë shumëfish më të larta se periudha para pandemisë.
- Vetëm 6, apo 23.7% nga 26 masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike ndikojnë direkt edhe tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.
- Vetëm 2 nga 26 masat, apo vetëm 8 milion nga 420 milion euro të Pakos së Ringjalljes Ekonomike u drejtohen direkt grave, përkundër që gjendja e tyre ekonomike llogaritet të jetë shumë më vështirë se e burrave.
- Vetëm 2, apo 7.7% nga 26 masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike ndikojnë pjesërisht tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.
- 7 nga 26 masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike kanë ndikim të pakët tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.
- 11 nga 26 masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike nuk kanë asnjë ndikim tek komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.
- Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Qeveria e Kosovës nuk e ka vendosur fare në konsultim publik, ashtu siç është e obliguar me dispozita ligjore.
- Qeveria nuk ka aplikuar metoda të duhura dhe të mjaftueshme në drejtim të informimit të qytetarëve për Pakon e Ringjalljes Ekonomike.

9. Rekomandime

- Qeveria e Kosovës por edhe komunat duhet të sigurohen se çdo ndihmë, pako, apo masë lidhur me kapërcimin e pasojave të pandemisë Covid 19, të jetë e drejtar kundrejt të gjitha shtresave të popullsisë, me theks të veçantë kundrejt atyre që pandemia i ka prekur më së shumti.
- Qeveria e Kosovës duhet ta fuqizoj Agjencinë e Punësimit, në mënyrë që e njëjta të mund t'i përbush funksionet që ka.
- Agjencia e Punësimit duhet të rris aktivitetet dhe të punoj në promovimin e punës së saj, për shkak se mbi 60% e qytetarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian as që janë të njojur për ekzistencën e saj.
- Qeveria, por edhe niveli komunal të ndërmarrin të gjitha masat që ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe sigurimin e kushteve të nevojshme ekonomike për komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, sepse gati 50% prej tyre kanë dekluaruar që pas pandemisë Covid 19 janë në një pozitë më të vështirë ekonomike.
- Qeveria dhe organet e rendit të ndërmarrin të gjitha masat që ndikojnë në uljen e rasteve të dhunës në familje, me theks të veçantë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët përbëjnë mbi 26% të rasteve yjetore të dhunës në familje në Komunën e Prizrenit.
- Institucionet të marrin masa në drejtim të informimit të qytetarëve dhe promovimit të mekanizmave ekzistues për mbrojtjen nga dhuna në familje, me qëllim që dhuna në familje të mos mbetet e padekluarar.
- Qeveria të sigurohet që secila pako e ndihmës ekonomike për qytetarët të drejtohet edhe kundrejt komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, sepse vetëm 23.7% e masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike ndikojnë direkt tek këta qytetarë.
- Qeveria të kujdeset se masat ekonomike janë të drejtuara në mënyrë direkte edhe tek gratë, kjo përfaktin se vetëm 2 nga 26 masat, apo vetëm 8 milion nga 420 milion euro të Pakos së Ringjalljes Ekonomike u drejtohen direkt grave

- Qeveria të kujdeset të para çdo mase apo pako ekonomike të zhvilloj konsultime të duhura në mënyrë që në ato masa të përfaqësohen të gjithë qytetarët.
- Qeveria të sigurohet se aplikon të gjitha masat dhe metodat e informimit të qytetarëve, në mënyrë që masat e caktuara të arrijnë tek secili qytetarë kundrejt të cilit janë drejtuar.

PRISHTINË,
SHTATOR 2022